

Ekuilibri është Çelësi

Fleta e Mësuesit

Vlerat Respekti, Liria, Përgjegjësia, Vetedisciplinimi, Solidariteti, Angazhimi, Barazia.

Qëllimet **Pedagogjik:** Reflektimi rreth rëndësisë së sferave të jetës dhe ekuilibri midis tyre.

Praktik: Gjetja e nje zgjidhjeje për problemet që pengojnë ekuilibrin midis punës dhe familjes.

Pjesëmarrësit Minimumi: 8 pjesëmarrës
Maksimumi: 30 pjesëmarrës

Kohëzgjatja 60 deri 90 minuta

Materialet Letër dhe stilolaps.

Permbledhje Mësuesi e ndan klasën në grupe prej 3-4 nxënësish dhe i dorëzon secilit grup një problem që lidhet me arritjen e ekuilibrit, siç është e shënuar më poshtë. Grupi duhet të analizojë problemin dhe të reflektojë rreth zgjidhjeve të mundshme për ta tejkaluar. Secili grup paraqet problemin dhe zgjidhjet e mundshme përpara klasës. Klasa duhet të diskutojë mbi zgjidhjet e paraqitura, duke theksuar avantazhet dhe disavantazhet e tyre. Mësuesi mund të mbajë shënim në tabelë vështirësitë kryesore dhe zgjidhjet e propozuara.

Probleme në lidhje me ekuilibrimin:

Situata 1


Një çift me dy fëmijë të vegjël.

Gjatë një muaji, një nga fëmijët duhet të shkojë çdo ditë në spital, mbasdite, për të ndërruar fashon në dhomën e infermierisë.

Situata 2

Nënë e vetme me një fëmijë 6-vjeçar.

Për dy muaj rresht, nëna do të marrë pjesë në një sesion trajnimi, që zhvillohet në mbrëmje dy herë në javë, i paguar nga kompania ku ajo punon.



Ekulibri është Çelësi

Fleta e Mësuesit (vazhdim)

Përmbledhje (vazhdim)

Situata 3

Baba i divorcuar, i cili çdo dy javë kalon fundjavat me fëmijët e tij. Babai duhet të përgatisë një projekt urgjent gjatë fundjavës dhe ta prezantojë në punë të hënën në mëngjes. Ai u kishte premtuar fëmijëve të tij që do ti çonte për të parë një turne tenisi gjatë asaj fundjave.

Situata 4

Nëna e sëmurë kronike dhe një djalë 25 vjeç. Nëna fton djalin për një festë tradicionale që organizohet çdo 4 vjet. Djali ka një prezantim të rëndësishëm në punë javën që vjen dhe ka nevojë për kohë për ta përgatitur.

Situata 5

Baba i Ve me dy fëmijë. Babai mori një ofertë pune me një pagë më të mirë, por orari i punës nuk e lejon që të marrë fëmijët e tij nga shkolla çdo ditë në orën 17:00, duke qënë e nevojshme të kërkojë zgjatje orari për qëndrimin e tyre deri në orën 19:00.

Diskutimi

Pas prezantimit të zgjidhjeve për problemet në lidhje me ekuilibrin, duhet të bëhet një analizë e përgjithshme e aktivitetit dhe të nxitet një debat midis nxënësve.

Çfarë është arritja e ekuilibrin? Cilat janë ndërlikimet e mundshme? Çfarë ndjetë kur u përballët me problemet?

Pse është rritur vështirësia pëer arritjen e ekuilibrin midis sferave më të rëndësishme të jetës?

Keni pasur ndonjë vështirësi për të arritur ekuilibrin midis aktiviteteve tuaja shkollore me ato familjare? Si e përballuat situatën?

Cilat janë vështirësitë kryesore të ekuilibrin që përballojnë prindërit tuaj? Çfarë mund të bëni për t'i ndihmuar?

